



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:273991
Datë: 15.05.2024
Numri i dokumentit: 05689450

C – IV. - 14 - 6315

Paditësi:

Z H G nga Prishtina.

Kundër

E paditura:

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, Lagjja, "Lakrishtë", Rr."Dritan Hoxha", nr.55, Prishtinë.

Objekti i çështjes : Kompensimi i pagave të pa paguara.

Për : Palët ndërgjyqëse.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), me gjykatësin e vetëm, Agron Hoxhaj, jashtë seancës dëgjimore, me **dt.15.05.2024**, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit, Z G nga Prishtina e paraqitur kundër të paditurës, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, dhe Vendimi, PRN125 - 0265 i dt.28.09.2014 i Autoritetit të Likuidimit (AL) i Agjencisë së Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë për Ndërmarrjen Shoqërore (NSh), "Banka Themelore e Kosovës" me seli në Prishtinë (në likuidim), **VËRTETOHET si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale në këtë çështje juridike kontestimore.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me dt.29.09.2014, paditësi, Z G nga Prishtina, pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK), ka parashtruar, kërkesë për ri shikimin e Vendimit, PRN125 -0265 i dt.28.09.2014 të Autoritetit të Likuidimit në kuadër të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) lidhur me Ndërmarrjen Shoqërore (N.Sh), "Banka Themelore e Kosovës" me seli në Prishtinë (në likuidim) e me të cilin i është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa e tij për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhë 1990 - 1999 e në shumën prej 37.097.60 € nga Ndërmarrja Shoqërore (N.Sh), "Banka Themelore e Kosovës" me seli në Prishtinë (në likuidim).

Në arsyetimin e këtij Vendimi të AL-së, dhe atë për Vendimin, PRN125 -0265 i dt.28.09.2014 për kompensimin e pagave të pa paguara në shumën e pa përcaktuar për periudhë 1990 - 1999 nga Ndërmarrja Shoqërore (NSh), "Banka Themelore e Kosovës" me seli në Prishtinë (në likuidim), është cekur se AL-ja, ka konstatuar se pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruesit, e këtu paditësit, ka vlerësuar se ajo është e pa vlefshme e duke u bazuar në dispozitën e nenit 36 par.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L-034, lidhur me atë se kërkesa e paditësit, është e pa vlefshme dhe i cili parasheh se : " ... *elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është parashkruar sipas kufizimeve kohore të aplikueshme*", se neni në fjalë, i ka dhënë AL-së, të drejtën të vërtetoj nëse kërkesa është parashkruar nga ligjet në fuqi të aplikueshme në territorin e Republikës së Kosovës e më saktësisht ka theksuar se neni 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (i publikuar në Gazetën Zyrtare, Nr.53 të viti 1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.1999/24) , parasheh se : "*Pagesa e shumës së pagës apo rrogës ose të ndonjë kërkesë tjetër të punëtorëve që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet*", dhe se AL-ja, në bazë të dispozitave të mësipërme një kërkesë monetare e çfarëdo lloji, që një punëtor mund të ketë ndaj një punëdhënësi dhe që e ka burimin nga marrëdhënia kontraktuale midis dy palëve, duhet të jetë e paraqitur në gjyq apo ndonjë autoritet kompetent brenda tre viteve nga momenti kur NSh-ja, supozohet të mos ketë përmbushur detyrimet e saj monetare ndaj parashtruesit (pra tre vite nga viti 1990) prandaj edhe AL-ja e ka refuzuar si të pa vlefshme kërkesën e paditësit në procedurën e likuidimit.

Paditësi në padinë e tij thekson se arsyetimi i vendimit të atakuar është i gabuar sepse aplikimi i dispozitave të nenit 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, është i pa justifikuar dhe i pa bazuar sepse ky ligj, jo vetëm në territorin e Republikës së Kosovës por as në territoret e ish Republikave Jugosllave, tani më nuk është i aplikueshëm e ky ligj ka pushuar së aplikuari në veçanti në territorin e Republikës së Kosovës, pas miratimit të Rezolutës së 1244 të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, se nga ana tjetër në bazë të nenit 87 të Ligjit të Punës, Nr.03/L – 212 të Republikës së Kosovës, të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para , parashkruhen brenda 3 vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës , kështu që duke u bazuar në publikimin e shpalljes së AKP-së publikuar në të përditshmen , "Koha Ditore" të dt.03.07.2014, për njoftimin e të gjithë kreditorëve që

kanë të bëjnë me kërkesat ndaj Bankës Themelore – Bankos Kosova, Sh.a–Banka e Kosovës’’ me seli në Prishtinë, paditësi, në rastin konkret, kreditor, konsideron se me kohë dhe në afat është paraqitur me kërkesën e vet për kompensimin e pagave të pa paguara për afatin kohor prej viti 1990 deri në vitin 1999, se kreditori, nuk ka pasur mundësi e as fuçi ligjore t’i realizoj të drejtat e veta nga baza e marrëdhënies së punës dhe të kërkoj kompensimin e pagave të pa paguara për shkak të masave të dhunshme të cila janë aplikuar në kohën kur janë larguar nga puna.

Tutje në këtë padi, paditësi, ka shtuar edhe se Banka Popullore e Jugosllavisë me aktvendimin për plotësimin e kushteve për hapjen e procedurës së falimentimit ndaj Bankës së Kosovës, me dt.03.10.1990, ka propozuar fillimin e hapjes së procedurës së falimentimit, e kështu Gjykata Ekonomike e Qarkut në Beograd, si gjykatë në procedurën e falimentimit, me shifrën ST 207/90 të dt.13.12.1990, e ka nxjerrë aktvendimi me të cilin, ka filluar procedura e falimentimit të Bankës së Bashkuar të Kosovës, Sh.A nga Prishtina e me propozimin që të ndryshohet Vendimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, Nr.10968 i dt.28.08.2014 që ka të bëjë me kërkesën e paditësit, për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën prej vitit 1990 deri në vitin 1999, ish punëtor i Bankës së Bashkuar të Kosovës, ’’Banka Themelore e Kosovës’’, të aprovohet kërkesëpadija e tij, ish punëtor i Bankës së Bashkuar të Kosovës, ’’Banka Themelore e Kosovës’’ dhe të njëjti t’i kompensohen pagat e pa paguara për periudhën prej vitit 1990 deri në vitin 1999 në shumën prej 37.097.60 € dhe atë prej ditës së ushtrimit të kësaj padie e deri në ditën e realizimit të tyre me kamatë bankare sipas normës së kamatës të bankave afariste në territorin e Republikës së Kosovës e më gjerësisht si në këtë padi

Padisë së tij si provë, paditësi, ia ka bashkangjitur vetëm Vendimin e kundërshtuar të AL-së, PRN125 -0265 të dt.28.09.2014 dhe asnjë provë tjetër.

Me dt.07.04.2023, e paditura, AKP me seli në Prishtinë përmes përfaqësuesit të saj, duke vepruar sipas Urdhrit të kësaj gjykate, C – IV. – 14 – 6315 të dt.16.03.2023, në këtë gjykatë ka parashtruar mbrojtjen e saj në kërkesën e paraqitur nga pala paditëse ndër të tjera ka theksuar se me rastin e vendosjes, Autoriteti i Likuidimit, ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme janë zbatuar saktë, se ankesa e parashtruesit është e pa pranueshme pasi që objekt i kësaj procedure gjyqësore, është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria e me Ligjin, Nr.04/L-034) e Vendimit të AL-së, se parashtruesi, nuk ka treguar se cili nen i Ligjit, nr.04/L – 034 është shkëlur nga AL-ja,, se në pajtim me qëndrimin e vet parashtruesit, Vendimi, nuk bie në kundërshtim me asnjë dispozitë të Ligjit, Nr.04/L- 034 , se ankesa e paditësit, është e pa bazuar dhe se në bazë të nenit 36 par.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L-034, parashihet se : “ ... *elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është parashkruar sipas kufizimeve kohore të aplikueshme*’’, se neni 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (i publikuar në Gazetën Zyrtare, Nr.53 të vitit 1976), i aplikueshëm sipas nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut, Nr.1999/24), parasheh se :’’*Pagesa e shumës së pagës*

apo rrogës ose të ndonjë kërkesë tjetër të punëtorëve që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet'', e në bazë të dispozitave të mësipërme kërkesa duhet të jetë paraqitur në gjyq apo ndonjë organ tjetër kompetent brenda tre viteve nga momenti kur NSh-ja, pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit pra tre vite nga koha kur, NSh-ja, supozohet të mos ketë përmbushur detyrimet e saja monetare ndaj parashtruesit, këtu paditësit (pra nga viti 1990), prandaj edhe AL-ja, e ka refuzuar kërkesën si të pa vlefshme, e duke i propozuar gjykatës që të refuzoj ankesën si të papranueshme dhe të pa bazuar dhe t'a vërtetoj Vendimin e Autoritetit të Likuidimit, në pajtim me nenin 74.4 të Ligjit, Nr.06/L – 086 dhe se kësaj Mbrojtjeje, ia ka bashkangjitur një ekzemplar të Vendimit të AL-së, PRN125 -0265 të dt.28.09.2014 dhe Vendimin, DM 907/2022 të dt.01 nëntor 2002 për emërimin e anëtarëve të AL-së për Ndërmarrjen Shoqërore (NSh), ''Banka Themelore e Kosovës'' me seli në Prishtinë (në likuidim).

Me dt.28.04.2023, me Urdhrin e saj, C – IV. – 14 – 6315 të dt.28.04.2023, dhe me Urdhrin e saj, C – IV. – 14 – 6315 të dt.02.10.2023, kjo gjykatë, mbrojtjen e të paditurës, ia ka adresuar paditësit, për të dhënë përgjigje në këtë mbrojtje, dhe atë në 2 adresat e paditësit mirëpo pa sukses sepse ka rezultuar se në adresën, ..nr., Prishtinë, pala është shpërngulur kurse në adresën ..nr., Prishtinë (përmes kësaj adrese e pa bërë pagesën e taksës gjyqësore për padi), ka rrjedh se adresa është jo e plotë .

Me dt.16.11.2023, DhPGjSK-ja, me Lejen e saj, C – IV. – 14 – 6315 të dt.16.11.2023 për dorëzimin konstruktiv të dokumenteve, ka bërë publikimin e mbrojtjes së të paditurës, AKP-së për të dhënë përgjigje në këtë mbrojtje dhe se sipas Shënimit Zyrtar, C – IV. – 14 – 6315 të dt.03.01.2024 të referentit të DhPGjSK-së, kjo leje me ekzemplarin e Mbrojtjes së të paditurës, AKP-së, ka qëndruar në tabelën e Shpalljeve të kësaj gjykate prej dt.16.11.2023 deri me dt.04.12.2013 dhe se pas publikimit të saj në tabelën e Shpalljeve të kësaj gjykate, gjykata ka konsideruar se pala paditës, e ka pranuar me kohë mbrojtjen e të paditurës, dhe se pas kalimit të afatit të dhënë në këtë Shënim Zyrtar, konsiderohet se paditësi, nuk ka vepruar sipas Urdhrave të kësaj gjykate, C – IV. – 14 – 6315 të dt.28.04.2023 dhe C – IV. – 14 – 6315 të dt.02.10.2023 për të paraqitur Përgjigje në mbrojtje të të paditurës, AKP-së.

Arsyetimi Ligjor

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par. 1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme lidhur me nenin 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe gjykata merr aktgjykim, pa caktuar seancës dëgjimore.

Po ashtu në nenin 76 paragrafi 3 i Ligjit Nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), parashihet se: *“Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”* derisa sipas nenit 7 par. 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se : *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*.

Pas shqyrtimit të provave të lëndës parashtrimeve dhe pretendimeve të palëve në procedurë gjykata ka ardhur në përfundimin se kërkesëpadija e paditësit, Z G nga Prishtina, duhet të refuzohet e pabazuar.

Pranueshmëria dhe afatshmëria e kërkesës së paditësit.

Gjykata, ka shqyrtuar provat të cilat i kanë ofruar palët ndërgjyqëse dhe ka konstatuar se Ndërmarrja Shoqërore (N.Sh), ”Banka Themelore e Kosovës, “Bankos” me seli në Prishtinë, ka hyrë në procedurë të likuidimit me dt.16.06.2014 ndërsa parashtruesi në procedurën e likuidimit, kërkesën e tij pranë AL-së, e ka bërë me dt.05 Gusht 2014, e që është brenda afatit për parashtrimin e kërkesave në procedurën e likuidimit derisa AL-ja, me Vendimin e tij, PRN125-0265 të dt.28.09.2014, e ka refuzuar si të pa vlefshme kërkesën e tij për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhë 1990-1999 e në shumën prej 37.097.60 € nga Ndërmarrja Shoqërore (N.Sh), ”Banka Themelore e Kosovës” me seli në Prishtinë (në likuidim) kurse pas pranimit të këtij Vendimi pas dt.28.08.2014, padinë e tij pranë DhPGJSK-së, paditësi e ka bërë me dt.29.09.2014, pra brenda afatit të paraparë ligjor prej 30 ditëve pas ditës së pranimit të Vendimit të kundërshtuar të Autoritetit të Likuidimit (AL), dhe se të njëjtës kërkesë/padi, ia ka bashkangjitur Vendimin e kundërshtuar të AL-së, PRN125-0265 të dt.28.09.2014, andaj gjykata, vlerëson se padija e bërë nga paditësi, kundër këtij Vendimi të kundërshtuar të AL-së, PRN125-0265 të dt.28.09.2014, i plotëson kriteret e pranueshmërisë dhe afatshmërisë në aspektin procedural sipas dispozitave ligjore nga neni 36 dhe 74 Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK) lidhur me nenin 37 par.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në.

Faktet jo kontestuese dhe kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse.

Gjykata gjen se kontestuese fillimisht, është fakti se në mes të palëve ndërgjyqëse, se a ka qëndruar raporti juridik i marrëdhënies së punës në mes të ankuesit dhe Ndërmarrjes Shoqërore (N.Sh), ”Banka Themelore e Kosovës, “Bankos” me seli në Prishtinë edhe pse i njëjti fakt nuk kontestohet nga palët ndërgjyqëse, por kontestuese mes palëve, është se pala paditëse a ka të drejtë që të kërkoj nga e paditura kërkesën për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhë 1990 - 1999 e në shumën prej 37.097.60 € nga Ndërmarrja Shoqërore (N.Sh), ”Banka Themelore e Kosovës” me seli në Prishtinë (në likuidim), si dhe se fakti se paditësit, kërkesën e tij nga lëmia e marrëdhënies së punës, a e ka bërë brenda afatit të paraparë ligjor apo jo.

Në nenin 6 të Ligjit Nr.04/L – 034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), që flet për fushëveprimin e kompetencave administrative të Agjencisë, aty thuhet se : *''Agjencia ka kompetenca të gjëra dhe ekskluzive administrative mbi të gjitha ndërmarrjet, asetet, interesat, aksionet dhe pronën që bie në fushëveprimin e nenit 5.1 dhe 5.2.''* .

Në rastin konkret, gjykata ka konstatuar se kërkesa e paditësit, ka të bëjë me kërkesat e pa siguruara përfshirë kërkesat për paga, si në nenin 40 par.1 pika 1.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në e në të cilin, parashihet se : *''Në procedurat e likuidimit të gjitha kërkesat e kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 më poshtë dhe sipas renditjes në vijim: ...kërkesat e pa siguruara, përfshirë kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë''* .

Në nenin 36 par.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L -034, parashihet se : *“ ... elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkese apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë: kërkesa apo pretendimi është parashkruar sipas kufizimeve kohore të aplikueshme’’* derisa në nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, parashe se : *''pagesa e shumës së pagës apo rrogës ose të ndonjë kërkesë tjetër të punëtorëve që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet''*. Po shtu edhe në nenin 77 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) i vitit 1978 gjithashtu, parashihet afati i njëjtë kohor për parashkrimin e të gjitha kërkesave me para si rezultat i marrëdhënies së punës.

Po ashtu në nenin 42 par.3 i Ligjit nr.06/L – 086, në mënyrë shprehimore, thuhet se *“... Nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë...’’*. Gjykata gjen se parashtruesi, këtu paditësit sikurse në procedurën e likuidimit me rastin e parashtrimit të kërkesës për ri shikimin e Vendimit të kundërshtuar të AL-së po ashtu edhe në procedurën gjyqësore sipas padisë së bërë pranë DhPGjSK-së, nuk ka paraqitur ndonjë fakt apo provë me të cilën gjykata mund të vendoste ndryshe nga AL-ja me rastin e refuzimit të kërkesës, andaj AL-ja me rastin e shqyrtimit të kërkesës së paditësit, ka vërejtur në se kërkesa e paditësit, është e parashkruar dhe se me rastin e parashtrimit të padisë kundër Vendimit të kundërshtuar të AL-së, pranë DhPGjSK-së, nuk ka bashkangjitur provat gjegjëse si dhe se është konstatuar se paditësi për kërkesën për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhë 1990 - 1999 e në shumën prej 37.097.60 € nga Ndërmarrja Shoqërore (N.Sh), *''Banka Themelore e Kosovës''* me seli në Prishtinë (në likuidim), nuk ka sjellur asnjë vendim të plotëfuqishëm i cili e detyron NSh-në, që t'ia kompensoj pagat e e pa paguara për periudhën në fjalë.

Gjykata gjen se pretendimet e paraqitura nga paditësi nuk konsistojnë me asnjë provë me të cilën gjykata mund të vepronte në miratimin e kërkesës, pasi që një kërkesë e tillë duhet të paraqitet me fakte dhe prova, e me të cilën gjykata mund të vendoste me fakte vendimtare se pretendimet e paditësit janë të bazuara në prova, dhe se paditësit, AL-ja me të drejtë, në procedurën e likuidimit, ia ka refuzuar si të vlefshme kërkesën e parashtruesit, këtu paditësit, derisa paditësi që me rastin e parashtrimit të padisë ka pasur

mundësi që të paraqesë çdo provë të mundshme në arsyetimit e kërkesës, por me rastin e parashtrimit të padisë nuk ka bashkangjitur provat gjegjëse në mbështetje të kërkesës së tij për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhë 1990 - 1999 e në shumën prej 37.097.60 € nga Ndërmarrja Shoqërore (N.Sh), "Banka Themelore e Kosovës" me seli në Prishtinë (në likuidim) ndërsa me rastin e dërgimit të mbrojtjes së të paditurës përmes Shpalljes së saj në Tabelën e Shpalljeve të DhPGjSK-së), pas qëndrimit të saj në Tabelën e Shpalljeve pranë DhPGjSK-së, gjykata konsideroj se paditësi, nuk ka paraqitur Përgjigje në Mbrojtje si dhe se nuk ka sjellur asnjë vendim të plotëfuqishëm i cili e detyron NSh-në, që t'ia kompensoj pagat e pretenduara e të pa paguara.

Gjykata vëren edhe se kërkesa e parashtruar nga paditësi, nuk është bërë brenda afatit të paraparë ligjor për të kërkuar kompensimin e pagave të pa paguara nga NSh-ja në fjalë, si palë e paditur pasi që paditësja, nuk ka arritur që të bind gjykatën se para se t'i drejtohet AL-së, të ketë paraqitur padi për realizimin e kësaj kërkesë dhe se me gjendjen e tillë të shkresave të lëndës, kërkesë e tij është edhe e parashkruar sepse paditësi, nuk ka ofruar prova se para dt.05.08.2014, kërkesën e tij për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën 1990 - 1999 e në shumën prej 37.097.60 € nga Ndërmarrja Shoqërore (N.Sh), "Banka Themelore e Kosovës" me seli në Prishtinë (në likuidim), t'a ketë bërë - paraqitur në gjykatë apo ndonjë organ tjetër kompetent brenda tre viteve nga momenti kur NSh-ja, pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit, këtu paditësit e më së voni nga viti 1990.

Vlerësimet përfundimtare të çështjes nga ana e gjykatës

Gjykata vlerëson se, pas administrimit dhe vlerësimit të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, e pas konstatimit të gjendjes faktike, ka ardhur në përfundimin se qëndrimi i të paditurës i shprehur në Vendimin e Autoritetit të Likuidimit (AL), PRN125-0265 të dt.28.09.2014, ku e ka bërë refuzimin si të pa vlefshme të kërkesës së paditësit për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën 1990 - 1999 e në shumën prej 37.097.60 € nga Ndërmarrja Shoqërore (N.Sh), "Banka Themelore e Kosovës" me seli në Prishtinë (në likuidim), është i drejtë, e duke u bazuar në 36 par.2.1 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L -034, dhe në nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar, se kërkesa e tij për pagat e pa paguara, është e parashkruar dhe se këtë qëndrim e pranon edhe kjo gjykatë, si dhe se paditësi, as në procedurës së zhvilluar pranë DhPGjSK-së, nuk ka ofruar prova se para dt.05 Gusht 2014, kërkesën e tij për kompensimin e kësaj kërkesë, t'a ketë bërë - paraqitur në gjykatë apo ndonjë organ tjetër kompetent brenda tre viteve nga momenti kur NSh-ja, pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj parashtruesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, pra tre vite nga koha kur parashtruesi nuk ka përfituar nga ndërmarrja të ardhurat personale e pretenduara, si dhe se i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë në mbështetje të kërkesës së tij. Andaj me arsyet e cekura më lartë, kjo gjykatë kërkesëpadinë e paditësit, Z G nga Prishtina për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhë 1990 - 1999 e në shumën prej 37.097.60 € nga Ndërmarrja Shoqërore (N.Sh), "Banka Themelore e Kosovës" me seli në Prishtinë (në likuidim), e

refuzoj si të pa bazuar derisa Vendimin, PRN125-0265 të dt.28.09.2014 të Autoritetit të Likuidimit (AL) të Agjencisë së Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë, e vërtetoj si të drejtë dhe i bazuar në ligj.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse por të njëjtat ishin pa efekt në vendosjes ndryshe të kësaj çështje juridike, dhe nuk e konsideron të nevojshme të japë arsyetime tjera ligjore.

Shpenzimet Gjyqësore

Në bazë të nenit 62 par.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) dhe Udhëzimit Administrativ, Nr.01/2017 të KGJK-së për Unifikimin e Taksave Gjyqësore përkatësisht nenit 13.3 dhe 13.9, të këtij Udhëzimi, gjykata vendosi që secila palë t'ia bartë shpenzimet e veta procedurale.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, nenit 54 par.1 dhe nenit 74 par.4 të Ligjit nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK).

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS **2022:273991, 15.05.2024**

Gjykatësi,
Agron Hoxhaj

KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimi të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK).